



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K2/M17-8 Prot.
Nr. Dok. 202503111/8

Tiranë 18/12/2025

Lënda: Rekomandim për ndryshimin e Urdhrit nr. 719, datë 24.05.2018 të Ministrit të Mbrojtjes "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të shqyrtimit të ankesave për vlerësimin e ushtarakëve nga komisioni i karrierës", me qëllim unifikimin e procedurës administrative të njoftimit të palës, të përfshirë në një procedurë administrative, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurës Administrative.

MINISTRISË SË MBROJTJES
Tiranë

SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FORCAVE TË ARMATOSURA
Tiranë

KOMANDËS SË FORCËS AJRORE
Rruga Aeroportit, Rinas
Tiranë

Të nderuar,

I. Hyrje

Institucioni i Avokati i Popullit, në ushtrim të mandatit të tij kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, i ka kushtuar vëmendje respektimit të të drejtave të ushtarakëve, të cilët na janë drejtuar me ankesa jo vetëm sa i përket respektimit të të drejtave që burojnë nga statusi i tyre i veçantë, por edhe për respektimin e të drejtave që gëzojnë ushtarakët njëloj si të gjithë shtetasit e tjerë, në lidhje me të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Avokati i Popullit vlerëson se e drejta për një proces të rregullt ligjor, përbën një nga të drejtat themelore të parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kodin e Procedurës Administrative, si dhe në praktikën e Gjykatës Kushtetuese.

Në vijim, po sjellim në vëmendjen tuaj disa nga gjetjet dhe përfundimet e institucionit të Avokatit të Popullit, në trajtimin dhe hetimin administrativ të kryer për shqyrtimin e ankesës së nënkolonel M. B., e cila ka të bëjë me respektimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, gjatë një procesi administrativ.

II. Përshkrimi i rastit

Në institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë nënkolonel M. B., i cili pretendon se nuk është respektuar procedura ligjore *“për mënyrën e njoftimit të vendimit të Komisionit të shqyrtimit të ankesave, për vlerësimin e ushtarakëve nga komisionet e karrierës”*.

Më konkretisht nënkolonel M. B. shpjegon se: në datën 27.07.2023, ka paraqitur një ankesë me anë të postës, në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave¹, për vlerësimin e ushtarakëve nga komisionet e karrierës², pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Kjo ankesë ka të bëjë me vlerësimin e Komisionit të Lartë të Karrierës. Në muajin Gusht 2023, kohë kur ai ndodhej me pushim vjetor, është njoftuar në numrin e tij të telefonit, në WhatsApp, nga punonjës të sekretarisë së Komandës së Forcës Ajrore, se në emër të tij kishte mbërritur një shkresë. Pasi ka përfunduar pushimet vjetore, ai është paraqitur në sekretarinë e Komandës së Forcës Ajrore, për të tërhequr shkresën kundrejt nënshkrimit në regjistrin përkatës, por punonjësit e sekretarisë nuk kanë pranuar që ai të nënshkruajë. Për këtë arsye, nënkolonel M. B. nuk ka marrë në dorëzim shkresën dhe gjatë dy viteve të fundit i është drejtuar me disa ankesa Ministrisë së Mbrojtjes, ku ka kërkuar që përgjigja e vitit 2023, e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave t’i dërgohet nëpërmjet postës në adresën e tij të banimit ose t’i vihet në dispozicion nëpërmjet sekretarisë, kundrejt nënshkrimit, por nuk ka gjetur zgjidhje.

Në ankesën drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, Nënkolonel M. B., na ka vënë në dispozicion kopje të përgjigjeve që ka marrë nga Drejtoria e Inspektimit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes. Më konkretisht:

¹ Ushtarakët, që janë marrë në shqyrtim për gradën e radhës, mund të ankohen për vlerësimin e komisionit të karrierës te Ministri i Mbrojtjes, ku krijohet një komision i posaçëm për shqyrtimin e ankesave. Procedurat dhe funksionimi i komisionit të shqyrtimit të ankesave përcaktohen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm. (neni 28 i Ligjit nr.59/2014 *“Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”*).

² Komisionet e karrierës janë autoritetet përgjegjëse për vlerësimin e përparimit të ushtarakëve në gradë, si dhe për kualifikimet që shërbejnë për marrjen e gradës së radhës (neni 22 i Ligjit nr.59/2014 *“Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”*).

- Shkresa Nr.188/2 Prot., datë 20.09.2023, ku thuhet se ai ka marrë përgjigje nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave me shkresën Nr. 5961/1 Prot., datë 15.08.2023.
- Shkresa Nr. 207/1 Prot., datë 27.10.2023, ku thuhet se ai ka marrë përgjigje më parë me shkresën Nr.188/2 Prot., datë 20.09.2023.
- Shkresa Nr.78/1 Prot., datë 12.05.2025, ku thuhet se ai ka marrë përgjigje nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave me shkresën nr.7124/1 Prot., datë 12.11.2024, por ka refuzuar ta marri në sekretarinë përkatëse. Lidhur me këtë praktikë, nënkolonel M. B. sqaron se kjo shkresë e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, ka të bëjë me vlerësimin e përparimit në gradë të vitit 2024 dhe jo të vitit 2023, për të cilën ka paraqitur ankesë dhe mbetet në pritje të një përgjigje.

Në këto rrethana, Nënkolonel M. B. ka kërkuar ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit për të verifikuar pretendimin e tij dhe për të gjetur zgjidhje.

Për shqyrtimin e ankesës së nënkolonel M. B., institucioni ynë iu drejtua Ministrisë së Mbrojtjes me shkresën Nr. K2/M17-3 Prot., datë 30.07.2025, e përsëritur me shkresën Nr. K2/M17-6 Prot., datë 23.09.2025, si dhe Komandës së Forcës Ajrore me shkresën Nr. K2/M17-2 Prot., datë 30.07.2025, ku kemi kërkuar të informohemi për sa më poshtë vijon:

- A ka dhënë një vendim Komisioni i shqyrtimit të ankesave, mbi vlerësimin e komisionit të karrierës të vitit 2023, për nënkolonel M. B.? Nëse po, cila është mënyra e përdorur për t'i njoftuar nënkolonel M. B., vendimin e vitit 2023, të Komisionit të shqyrtimit të ankesave, nëpërmjet postës apo administratës së FA/Ministrisë së Mbrojtjes dhe arsyeja e përzgjedhjes së kësaj mënyre?
- Nëse vendimi i Komisionit të shqyrtimit të ankesave, mbi vlerësimin e komisionit të karrierës të vitit 2023, për nënkolonel M. B., është adresuar në Komandën e Forcës Ajrore, ku ushtaraku shërbente në atë kohë, në cilën datë është adresuar?
- A është përcjellë në Komandën e Forcës Ajrore vendimi i vitit 2023, i Komisionit të shqyrtimit të ankesës së nënkolonel M. B., për vlerësimin e komisionit të karrierës? Nëse po, në cilën datë është protokolluar ky vendim dhe cila ka qenë mënyra e komunikimit me nënkolonel M. B., për ta vënë në dijeni mbi përgjigjen e ardhur në emër të tij?
- A është paraqitur nënkolonel M. B. në sekretarinë e Komandës së Forcës Ajrore, për të marrë në dorëzim shkresën e Komisionit të shqyrtimit të ankesave dhe a kanë proceduar punonjësit e sekretarisë për t'ia dorëzuar kundrejt nënshkrimit?
- A janë kryer verifikime nëse është respektuar procedura ligjore për dorëzimin e shkresës, në rastin e nënkolonel M. B.?
- A janë kryer verifikime në njësitë e Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes, nëse ushtarakët i marrin në dorëzim vendimet e Komisionit të shqyrtimit të ankesave, kundrejt nënshkrimit në regjistrin përkatës?

Në përgjigje të këtyre kërkesave, Komanda e Forcës Ajrore ka dërguar informacion me shkresën Nr. 4293/1 Prot., datë 12.08.2025, ndërsa Ministria e Mbrojtjes ka dërguar informacion me shkresën Nr.5481/1 Prot., datë 07.10.2025.

Ministria e Mbrojtjes ka shpjeguar sa më poshtë:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me shkresën nr. 5961, datë 15.08.2023 “Kthim përgjigje”, i ka kthyer përgjigje Nënkolonel M. B. në Repartin Ushtarak nr. 3001, Rinas, Tiranë. Nënkolonel M. B., i cili nuk ka qenë prezent në repart është njoftuar nëpërmjet platformës WhatsApp, për shkresën e dërguar në emër të tij, në sekretarinë e komandës ku shërben. Sekretaria e repartit ushtarak nr. 3001 e ka telefonuar N/kolonel M. B., por ai nuk ka pranuar që të njihet me praktikën e ardhur me pretendimin se kthimi i përgjigjes duhet t’i dërgohet në adresën, në të cilën ai ka paraqitur ankesën (nëpërmjet shërbimit postar shtetëror).

Lidhur me pretendimin se nuk janë zbatuar procedurat ligjore për mënyrën e njoftimit të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, bazuar në nenin 9 “Procedura për përgatitjen e ankesave nga ushtarakët”, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të shqyrtimit të ankesave për vlerësimin e ushtarakëve nga komisionet e karrierës”, theksohet se “ankuesi mund të përcjellë ankesën përmes degëve të sekretarive të komandave të njëjësive, reparteve apo nënreparteve ku shërben ose nëpërmjet shërbimit postar”.

Komanda e Forcës Ajrore e ka njoftuar në repartin ku shërben dhe nuk është e detyruar të dërgojë korrespondencën në adresën ku banon, pasi ka qenë efektiv i Forcës Ajrore.

Për sa i përket pyetjes nëse janë kryer verifikime në strukturat e Forcave të Armatosura dhe në Ministrinë e Mbrojtjes, nëse ushtarakët i marrin në dorëzim vendimet e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, shprehem se nuk ka pasur asnjë rast ankimi nga ushtarakët, përveç personit në fjalë.

Ndërsa, Komanda e Forcës Ajrore, ka shpjeguar sa më poshtë:

Nënkolonel M. B., pas njohjes me vlerësimin e bërë nga Komisioni i Lartë i Karrierës, për marrjen e gradës së radhës për vitin 2023, i është drejtuar Komisionit të shqyrtimit të ankesave, nëpërmjet shërbimit postar shtetëror, ku ka paraqitur pretendimet e tij në lidhje me vlerësimin e bërë nga Komisioni i Lartë i Karrierës.

Komisioni i shqyrtimit të ankesave, pas përfundimit të procesit të shqyrtimit të ankesave, nëpërmjet Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, ka dërguar në Komandën e Forcës Ajrore zarfin me nr. 5961, drejtuar Nënkolonel M. B., me shënim “personit në dorë”.

Personeli i sekretarisë në Komandën e Forcës Ajrore, më datë 16.08.2023, ka njoftuar në WhatsApp Nënkolonel M. B. që të paraqitej të merrte zarfin e ardhur, duke i dërguar foto të zarfit me nr. 5961/5, pasi ai po kryente pushimin vjetor nga data 07.08.2023 deri më 31.08.2023.

Zarfi i dërguar në emrin e Nënkolonel M. B., nuk është hapur dhe nuk është protokolluar, duke ruajtur konfidencialitetin dhe respektuar shënimin e bërë që duhet t'i jepej personit në dorë.

Pas konfirmimit të marrjes së mesazhit, Nënkolonel M. B., ka komunikuar me telefon me personelin e sekretarisë, ku i ka kërkuar që zarfi t'i kthehet dërguesit, me pretendimin që njoftimi duhet t'i shkojë nëpërmjet Shërbimit Postar Shtetëror, në adresën e banimit siç kishte dërguar ankesën.

Sekretaria e Forcës Ajrore ka kthyer në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura zarfin, me shënimin e njoftimit të personit dhe kërkesën e bërë nga Nënkolonel M. B., që t'i dërgohet me postë në adresën e banimit.

Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, ka kthyer përsëri në Sekretarinë e Forcës Ajrore, zarfin që duhet t'i dërgohej Nënkolonel M. B., sipas kërkesës në adresën e banimit.

Nënkolonel M. B. është njoftuar përsëri nëpërmjet WhatsApp se zarfi është rikthyer në sekretarinë e Forcës Ajrore dhe duhej të paraqitej për ta marrë, por përsëri ka ngritur të njëjtat pretendime.

Nëpërmjet ekspeditës zarfi është ridërguar në SHPFA dhe është rikthyer përsëri në Forcën Ajrore.

Nënkolonel M. B., është kthyer në detyrë më datë 01.09.2023, ku nga personeli i sekretarisë i është kërkuar që të merrte zarfin, por nuk ka pranuar që ta marrë duke ngritur të njëjtat pretendime.

Nga personeli i sekretarisë janë bërë shënimet përkatëse mbi zarfin dhe i janë dërguar në WhatsApp dhe nuk ka patur asnjë reagim.

Sekretaria e Forcës Ajrore, më datë 01.09.2023, nëpërmjet ekspeditës ka rikthyer zarfin në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

III. Baza ligjore dhe standardet ndërkombëtare

E drejta për një proces të rregullt ligjor, në veprimtarinë administrative përbën thelbin e garancive të të drejtave të qytetarëve në përballjen e tyre me administratën publike. Kjo e drejtë është e garantuar nga një sërë aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare. Konkretisht:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Vendimet e Gjykatës Kushtetuese;
- Kodi i Procedurës Administrative;
- Rekomandimi CM/Rec(2007)7, i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, drejtuar shteteve anëtare “Mbi mirëadministrimin”³;
- Ligji nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”;
- Urdhri nr. 719, datë 24.05.2018 i Ministrit të Mbrojtjes “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të shqyrtimit të ankesave për vlerësimin e ushtarakëve nga komisioni i karrierës”

- Kushtetuta e RSH

Neni 42

1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj **nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.**

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

- Praktika e Gjykatës Kushtetuese

Procesi i rregullt ligjor është një nga të drejtat e individit që lidhet jo vetëm me rregullsinë e një gjykimi në çështjet gjyqësore, por edhe me rregullsinë e një procesi administrativ. Neni 42/1 e Kushtetutës vetëm sa e përmend procesin e rregullt ligjor, por pa i dhënë atij ndonjë kuptim të hollësishëm. Atë që nuk e sqaron hollësisht Kushtetuta është përpjekur ta zhvillojë praktika e GJK.

Në vendimet e saj, GJK ka bërë edhe dallimin që ekziston ndërmjet nenit 6⁴ të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe nenit 42/1 të Kushtetutës së RSH. Ndërsa në Konventë parashikohet e drejta e individit për një gjykim të drejtë në procesin gjyqësor

³ <https://rm.coe.int/cmrec-2007-7-of-the-cm-to-ms-on-good-administration/16809f007c>

⁴ Neni 6 “E drejta për një proces të rregullt”

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.

penal apo civil, në nenin 42/1 të Kushtetutës dhe në jurisprudencën Gjykatës Kushtetuese, **e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter administrativ.** Kjo ka qenë një zhvillim i praktikës së GJK shqiptare, në vendimin e saj nr.76/2002.

- **Kodi i Procedurës Administrative, miratuar me Ligjin nr. 44/2015.**

Neni 1(Qëllimi i ligjit)

Ky Kod ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, në realizimin e këtyre funksioneve, duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor.

Neni 4 (Parimi i ligjshmërisë)

- 1. Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.*
- 2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor.*

Në Pjesën e Shtatë, nenet 147 – 163, parashikohen rregullat e përgjithshme dhe të veçanta të njoftimit të aktit administrativ, ku në nenin 149 përcaktohet se pala në një proces administrativ, si rregull njoftohet personalisht, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në Kodin e Procedurës Administrative.

- **Rekomandimi CM/Rec(2007)7, i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, drejtuar shteteve anëtare “Mbi mirëadministrimin”.**

Komiteti i Ministrave u rekomandon qeverive të shteteve anëtare:

- *Promovimin e mirëadministrimit brenda kuadrit të parimeve të sundimit të ligjit dhe demokracisë;*
- ...
- *Promovonin e të drejtës për mirëadministrim në interes të të gjithëve, duke miratuar, sipas rastit, standardet e përcaktuara në kodin model të bashkangjitur këtij rekomandimi, duke siguruar zbatimin e tyre efektiv nga zyrtarët e shteteve anëtare dhe duke bërë që çdo gjë të jetë e lejueshme brenda strukturës kushtetuese dhe ligjore të shtetit, për të siguruar që qeverisja vendore të miratojnë të njëjtat standarde.*

Kodi i mirëadministrimit

Seksioni I

Parimet e mirëadministrimit

Neni 2 – Parimi i ligjshmërisë

...

2. Atoritet publike duhet të veprojnë në përputhje me ligjin vendas, ligjin ndërkombëtar dhe parimet e përgjithshme të ligjit që rregullojnë organizimin, funksionimin dhe aktivitetet e tyre.

...

Seksioni II

Neni 18 – Publikimi i vendimeve administrative

...

2. Personat e prekur nga vendimet individuale duhet të njoftohen personalisht, përveç në rrethana të jashtëzakonshme kur vetëm format e publikimit të përgjithshëm janë të mundshme. Në të gjitha rastet, duhet të tregohen procedurat e ankimimit, përfshirë afatet kohore.

- **Ligji nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.**

Neni 28

1. Ushtarakët, që janë marrë në shqyrtim për gradën e radhës, mund të ankohen për vlerësimin e komisionit të karrierës te Ministri i Mbrojtjes. Ankimet bëhen brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit vetëm një herë.

2. Për shqyrtimin e ankesave, Ministri i Mbrojtjes krijon një komision të posaçëm të drejtuar nga një ushtarak me gradë madhore.

3. Komisioni i ngritur për shqyrtimin e ankesave vendos lënien në fuqi të vlerësimit të komisioneve të karrierës ose ndryshimin e këtij vlerësimi.

4. Procedurat dhe funksionimi i komisionit të shqyrtimit të ankesave përcaktohen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

IV. Konstatimet

Nga shqyrtimi i ankesës dhe informacionit të mbledhur, Avokati i Popullit vëren se:

Në rastin e Nënkolonel M. B. nuk është respektuar procedura administrative për dorëzimin personalisht të vendimit të Komisionit të shqyrtimit të ankesave për vlerësimin e ushtarakut nga komisionet e karrierës.

V. Vlerësimi institucionit të Avokatit të Popullit:

E drejta për një proces të rregullt ligjor është një e drejtë themelore kushtetuese e lidhur ngushtë sa me procesin gjyqësor aq edhe me atë administrativ.

Procesi i rregullt ligjor konsiderohet si një prej parimeve bazë të një shteti të së drejtës dhe qëndron në themel të procedurës administrative, ku bëjnë pjesë tërësia e rregullave që synojnë realizimin efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave.

Këto rregulla duhen respektuar përgjatë procedurës administrative, ku si të tilla përmendim: të drejtën për t'u dëgjuar; për t'u informuar; për të marrë pjesë vetë ose me përfaqësues ligjor në procedurën administrative; të drejtën për t'u ankuar; të drejtën për t'u njoftuar mbi vendimmarrjen etj.

Të gjithë këto rregulla, përbërës të procesit të rregullt ligjor në çdo procedurë administrative, parashikohen në Kodin e Procedurës Administrative, ku në nenin 3, pika 6 parashikohet se: *“Organ publik” është çdo organ i pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative, çdo organ i enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative; çdo organ i pushtetit vendor që kryen funksione administrative; çdo organ i Forcave të Armatosura, për aq kohë sa kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative publike”.*

Në rastin objekt shqyrtimi, Nënkolonel M. B. është ankuar se nuk është respektuar procedura ligjore për mënyrën e njoftimit të vendimit të Komisionit të shqyrtimit të ankesave, për vlerësimin e ushtarakëve nga komisionet e karrierës. Ai ka kërkuar që vendimi i vitit 2023, i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave t'i dërgohet nëpërmjet postës në adresën e banimit ose t'i vihet në dispozicion nëpërmjet sekretarisë, kundrejt nënshkrimit, por nuk ka gjetur zgjidhje.

Në Urdhrin nr. 719, datë 24.05.2018 të Ministrit të Mbrojtjes *“Për miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të shqyrtimit të ankesave për vlerësimin e ushtarakëve nga komisioni i karrierës”, nuk përcaktohet mënyra e njoftimit të vendimit të këtij komisionit, ushtarakut ankues.*

Ndërsa, në Pjesën e Shtatë *“Njoftimi”*, kreu I, të Kodit të Procedurës Administrative, përcaktohen rregullat për njoftimin e aktit administrativ.

Si rregull i përgjithshëm, në qoftë se nuk është parashikuar ndryshe me ligj, organi publik është i lirë të vendosë mënyrën e duhur të njoftimit të veprimeve administrative apo ndonjë njoftim tjetër, në kuadrin e procedurës administrative, shqyrtimit të mjeteve ligjore administrative ose procedurës së ekzekutimit të aktit administrativ, duke pasur parasysh efektivitetin e mënyrës së zgjedhur, mbrojtjen ligjore të interesave të palës, transparencën dhe koston (neni 147).

Në raste të veçanta, njoftimi i personave që ndodhen në shërbim në Forcat e Armatosura ose në njësitë e ministrisë që mbulon çështjet e brendshme, bëhet nëpërmjet administratës së tyre (neni 153/1).

Në kreun II, të Kodit të Procedurës Administrative, përcaktohen mënyrat dhe mjetet e njoftimit, ku në nenin 159 përshkruhet procedura e dorëzimit personalisht të shkresës. Këtë nen po e citojmë të plotë:

Neni 159 (Dorëzimi personalisht)

1. *Nëpunësi i organit publik i dorëzon personalisht shkresën marrësit në një nga vendet e njoftimit të parashikuara nga ky Kod. **Dorëzimi personalisht pasqyrohet në një procesverbal. Procesverbali përfshin të dhënat për identifikimin e shkresës së dorëzuar, datën e dorëzimit dhe nënshkruhet nga nëpunësi dhe marrësi.***
2. *Nëse marrësi nuk gjendet në vendin e njoftimit, nëpunësi i organit publik bën një përpjekje të dytë për dorëzimin personalisht, jo më parë se 24 orë dhe jo më vonë se 72 orë nga përpjekja e parë.*
3. *Kur marrësi nuk gjendet përsëri apo **kur ai refuzon marrjen në dorëzim, nëpunësi bën shënimin përkatës në një procesverbal dhe kur është e mundur e vërteton situatën me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm.*** Në këtë rast, nëpunësi i organit publik vendos një shënim në mjediset e vendit të njoftimit duke përcaktuar marrësin dhe zyrën përkatëse në organin publik ku mund të tërhiqet shkresa. Në shënim përcaktohet data dhe ora e lënies së shënimit dhe data që vlerësohet si data e kryerjes së njoftimit sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni.
4. *Dorëzimi, sipas pikës 3 të këtij neni, vlerësohet i kryer pas 3 ditëve nga data e vendosjes së shënimit.*
5. *Dorëzimi bëhet vetëm gjatë ditëve të punës, nga ora 7:00 deri në 19:00.*

Nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Komandës së Forcës Ajrore nuk na është vënë në dispozicion procesverbal i mbajtur nga nëpunësi i sekretarisë, i nënshkruar edhe nga një dëshmitar, ku të jetë shënuar se Nënkolonel M. B. ka refuzuar marrjen në dorëzim të shkresës së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave. Gjithashtu, nuk është ushtruar kontroll nëse ushtarakët i marrin në dorëzim vendimet e Komisionit të shqyrtimit të ankesave, kundrejt nënshkrimit të procesverbalit, me arsyetimin se nuk ka patur ankesa, përveç asaj të Nënkolonel M. B.

Nga ky hetim administrativ, rezultoi se të paktën në rastin e Nënkolonel M. B., nuk është respektuar procedura për dorëzimin personalisht të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.

Në vlerësimin tonë, barra e provës për shterimin e të gjithë procedurës administrative, është përgjegjësi e autoritetit publik.

Njoftimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, përbën veprimin e fundit administrativ, në procesin e vlerësimit të përparimit në gradë të një ushtaraku dhe vazhdimin e karrierës në Forcat e Armatosura.

Ky veprim administrativ është përbërës i procesit të rregullt ligjor dhe rëndësia e saj lidhet sa me të drejtën për t'u informuar aq edhe me afatet e ankimit në gjykatë.

Pala ka të drejtën e ankimit nga momenti i marrjes dijeni dhe dijenia konstatohet nga nënshkrimi në librin e dorëzimit me datë, për të dokumentuar këtë proces.

Edhe nëse do të qëndronte pretendimi i FA se, ushtaraku ka refuzuar të marrë dijeni shkresën, e drejta e ankimit do të niste përsëri në këtë datë. Edhe në këtë rast, barra e provës bie mbi administratën e FA.

Është shumë e rëndësishme zbatimi korrekt i procedurës administrative në lidhje me njoftimin e aktit kundrejt personit të interesuar, për shkak se cenohet e drejta e ankimit ndaj këtij akti individual, e drejtë kjo që buron nga momenti i komunikimit të përmbajtjes së shkresës në zarf dhe jo nga momenti i mbërritjes së një zarfi.

Marrja dijeni si koncept, në kuptimin administrativ, është thelbësore të evidentohet saktë dhe në mënyrë formale, të shkruar dhe jo verbale, fakt ky që nënkupton vënien në dijeni të përmbajtjes së aktit administrativ, shkresës zyrtare që ndodhet brenda zarfit.

Vetë organi administrativ që lëshon shkresën zyrtare ka detyrimin ligjor të evidentojë, jo vetëm për shkak provueshmërie, por për mos cenim të të drejtave themelore të çdo individi në kuadrin e respektimit të procesit të rregullt ligjor, fakt ky tashmë i evidentuar qartazi në qëndrimet e njohura të GJEDNJ-së.

Mos aplikimi i saktë i parashikimeve ligjore, në respekt të të drejtave të individit në një proces administrative, kurrësesi nuk ngarkon këtë të fundit me barren ligjore për të justifikuar mosveprimet korrekte të organit administrativ.

Në këto rrethana, çmojmë se strukturat në Forcat e Armatosura, të cilat kryejnë funksione administrative, duhet t'u japin rëndësi dhe të zbatojnë procedurat për njoftimin e akteve administrative.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut” si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”

REKOMANDOJMË:

- Ndryshimin e Urdhrit nr. 719, datë 24.05.2018 të Ministrit të Mbrojtjes “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të shqyrtimit të ankesave për vlerësimin e ushtarakëve nga komisioni i karrierës”, me qëllim unifikimin e procedurës administrative të njoftimit të palës, të përfshirë në një procedurë administrative, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurës Administrative.
- Zbatimin e procedurës administrative për dorëzimin personalisht të aktit administrativ, ushtarakëve dhe nëpunësve civilë, duke e pasqyruar këtë veprim në një procesverbal, një kopje e së cilit t’i vihet në dispozicion marrësit. Në rast refuzimi, nëpunësi përgjegjës të bëjë shënimin përkatës në një procesverbal, të vërtetuar edhe me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm.
- Përgjithësimin e këtij rasti në të gjithë strukturat e Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes, ku kryhen funksione administrative.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Besnik DEDA

D.V